



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1567/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar i Kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri anëtarë të Kolegjit, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit Kastrioti O.P. me seli në Shtime të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh.S avokat nga Lipjani kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i vendimit, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, KF.nr.776/2022 datës 30.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës-kundër propozueses Dogana e Kosovës në Prishtinë, e datës 12.09.2022, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, FK.nr.776/2022 i datës 30.08.2022, Vërtetohet.

A R S Y E T I M

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, është aprovuar si i bazuar propozimi i paditësit-propozuesit për caktimin e masës së përkohshme-shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë nr.01.03.2.2/7384 dt.26.05.2022, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të procesit gjyqësor.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditura, me të cilën e ka kundërshtuar Aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontstimore, dhe dispozitave të Ligjit për Gjykatën Komerciale, me propozimin që të aprovohet ankesa, të prishet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë si të pabazuar në ligj, dhe ta refuzon kërkesën e paditësit për shtyrje të ekzekutimit, ose t,ia kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar, e ka aprovuar kërkesën e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, me arsyetimin se paditësi nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e ka bërë të besueshme kërkesën e tij, se ekzekutimi i vendimit të goditur me padi do t'i sjellë dëm, i cili dëm vështirë do të riparohej dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit, nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës së kundërt. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet nga neni 22.6, i Ligjit për Konfliktin Administrativ, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues. Propozuesi në kërkesën për caktimin e masës së përkohshme, ka dëshmuar me prova marrëveshjet dhe kontratat për pagesën e obligimeve si dhe të qirave me zyrën përmbartimore, si dhe faturat me kompani tjera ku propozuesi figuron si debitor, pasqyrat bankare dt.13.06.2022, obligimet ndaj furnitorëve, punëtorëve, dhe si pasojë e këtyre obligimeve financiare ekziston mundësia e shkaktimit të dëmeve apo humbjeve të tilla, përkatësisht për cilat arsye caktimi i masës së përkohshme është i domosdoshëm dhe se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i pariparueshëm.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret propozuesi-paditësi me padi ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë nr.01.03.2.2/7384 dt.26.05.2022, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të procesit gjyqësor, me arsyetim se me ekzekutimin e vendimit të kontestuar propozuesit, do t'i sillte dëm të konsiderueshëm dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik e as nuk i shkakton dëm palës kundërshtare dhe personave të interesuar.

Pretendimet ankimore të palës së paditur, të shtjelluara si në arsyetim të ankesës për shkeljet e pretenduara nga gjykata e shkallës së parë, kolegji i vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për vendosjen e kësaj çështje në mënyrë tjetër, sepse nuk dëshmohet se aktvendimi i goditur është i nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore apo ligjit material, siç pretendon e paditura në ankesë. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit është se janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë nuk pranon pretendimet në ankesë, se Departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës Komerciale, është kompetent të vendos në këtë çështje të ekzekutimit të aktit administrativ-vendimit nr.03.1.1/7384 dt.26.05.2022 të paditurës. Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me një padi të paditësit-propozuesit dhe propozim për shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar i nxjerr nga e paditura në procedurën administrative të ankesave, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konstaton se kjo

çështje juridike kontestuese e iniciuar nga shoqëritë tregtare ndaj vendimeve përfundimtare të Doganës së Kosovës, ATK-së, trajtohet nga Departamenti Fiskal i Gjykatës Komerciale, në vështrim të nenit 13 paragrafi 4 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, prandaj edhe vendosja lidhur me propozimin e shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ hyn në kompetencë të Departamentit Fiskal të Gjykatës Komerciale

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, dhe se nuk është cënuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e aprovimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast e paditura në ankesën e ushtruar nuk ka bërë të besueshme me asnjë provë pretendimet e saj. Sipas vlerësimit të Kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1567/2022 datë 27.09.2022

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Krenar Berisha